



Treguesit Statistikorë të Tregut të Komunikimeve Elektronike 2019

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Shërbimet e komunikimeve elektronike mobile

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare _____	4
<i>Numri i përdoruesve celularë</i> _____	5
<i>Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G</i> _____	6
<i>Trafiku telefonik dhe SMS</i> _____	7
<i>Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve</i> _____	8
<i>Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare</i> _____	9
<i>Pjesët e tregut</i> _____	9
Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse _____	12
<i>Telefonia fikse</i> _____	12
<i>Aksesi broadband nga rrjete fikse</i> _____	14
<i>Numri i pajtimtarëve</i> _____	14
<i>Paketat e integruara (Bundles)</i> _____	17
<i>Teknologjia</i> _____	18
<i>Shpejtësia e aksesit broadband</i> _____	19
<i>Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse</i> _____	20
Të ardhurat dhe investimet _____	20

Lista e Figurave

Figura 1: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2015-2019	4
Figura 2: Numri i përdoruesve celularë aktivë dhe karta SIM 2014-2019	5
Figura 3: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2013-2019	7
Figura 4: Ecuria trafikut mujor on-net/off-net 2014-2019	7
Figura 5: Terminimi i thirrjeve dhe hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare (në minuta) dalëse	8
Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2019	12
Figura 7: Norma e penetrimit të Telefonisë Fikse sipas qarqeve dhe zonave Urbane/Rurale (2019)	13
Figura 8: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve	15
Figura 9: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2019)	16
Figura 10: Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	17
Figura 11: Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë Shqipëri 2019	18
Figura 12: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë	19
Figura 13: Të ardhurat nga Komunikimet Elektronike	21
Figura 14: Të ardhurat nga komunikimet elektronike për vitin 2019 sipas operatorëve kryesorë	21
Figura 15: Të ardhurat me shumicë dhe pakicë nga rrjetet celulare	22

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G	6
Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)	9
Tabela 3: Pjesët e tregut për treguesit kryesor të shërbimeve celulare	10
Tabela 4: Pjesët e tregut sipas numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2012 - 2019	13
Tabela 5: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve	14
Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete Fikse 2012-2019	15
Tabela 7: Numri i pajtimtarëve të Albtelecom me shërbime të integruara (2013-2019)	17
Tabela 8: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2014-2019	20

Shërbimet e komunikimeve elektronike mobile dhe rrjeteve fikse

Bazuar në rregulloren Nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar, të gjithë sipërmarrësit e autorizuar për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të rrjeteve fikse dhe mobile janë të detyruar të raportojnë në AKEP në mënyrë periodike të dhënat e tyre statistikore dhe financiare sipas afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.

Ky raport është përgatitur duke iu referuar të dhënave të dërguara nga operatorët celularë, si dhe të dhënave të Operatorëve Alternativë dhe Ofruesve të shërbimeve. Në disa raste AKEP nuk mund të dallojë parregullsitë e raportimit të të dhënave deri në momentin kur këto të dhëna do të krahasohen në periudhat në vijim. AKEP nuk mban përgjegjësi për cilësinë e të dhënave të raportuara nga operatorët. Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga operatorët publikohen nga AKEP. Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela për shkak të rumbullakimeve. Për këtë periudhë janë përdorur raportimet e 192 sipërmarrës që ushtrojnë aktivitet në ofrimin e shërbimeve të rrjeteve celulare, telefoni fikse dhe internet.

Dokumenti në vijim është strukturuar në tre seksione:

- Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare;
- Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse;
- Treguesit kryesorë të të ardhurave dhe investimeve.

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare

Aktualisht në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin tre sipërmarrës Albtelecom Sh.a, Telekom Albania Sh.a dhe Vodafone Albania Sh.a. Të tre sipërmarrësit kanë raportuar të dhënat sipas afateve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2015-2019 dhe norma e ndryshimit vjetor për vitin 2019 paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Figura 1: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2015-2019

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2018
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:						
- sipas kartave SIM	4,777,885	5,280,990	5,558,492	4,143,603	3,378,886	-18.46%
- Përdorues aktivë	3,442,665	3,490,686	3,625,699	2,714,878	2,630,076	-3.12%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:						
- Totali	2,049,072	2,739,550	3,345,045	2,657,015	2,462,057	-7.34%
- Përdorues aktivë	1,297,281	1,686,354	2,030,978	1,809,996	1,789,158	-1.15%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	7,381,147,348	6,793,769,155	6,619,674,715	6,019,006,073	5,494,296,034	-8.72%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	1,388,340,601	2,522,840,417	2,893,847,082	2,525,099,112	2,318,816,619	-8.17%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	420,253,147	300,227,063	168,753,020	164,608,604	213,311,650	29.59%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	1,598,702,865	1,610,322,977	1,400,142,526	1,212,559,068	967,833,263	-20.18%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	12,740,073	26,753,639	45,901,117	60,051,808	69,135,490	15.13%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Nga të dhënat e tabelës vërehet se ashtu si gjatë vitit 2018 ka pasur ulje të ndjeshme për disa nga treguesit e paraqitur, konkretisht numri i pajtimtarëve sipas kartave SIM ka shënuar rënie me rreth 18% gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin 2018, ulje ka pasur edhe numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare por kjo ulje ka qenë më e vogël me rreth 3% krahasuar me vitin 2018. Të njëjtin trend rënës kanë shënuar edhe numri i përdoruesve me akses broadband nga rrjetet mobile përkatësisht me rreth 7% numri i përdoruesve me akses broadband mobile dhe me rreth 1% numri i përdoruesve aktivë të internetit krahasuar këto me vitin 2018. Gjithashtu, rënie ka pasur edhe për sa i përket volumit të thirrjeve dalëse celulare me rreth 8%, numrit të SMS të dërguara nga përdoruesit me rreth 20%, si edhe volumit të thirrjeve hyrëse kombëtare të cilat janë ulur me rreth 8% krahasuar këto me vitin 2018. Për sa i përket rënies së numrit të SMS-ve dhe minutave të komunikimit Voice, kjo ka ardhur edhe si rezultat i përdorimit në masë të aplikacioneve OTT (Whatsapp, Viber, Messenger, Skype, etj.) nëpërmjet të cilëve dërgohen mesazhe tekst dhe kryhen thirrje zanore dhe 'video calls'. Komunikimi nëpërmjet këtyre aplikacioneve ka ardhur gjithnjë në rritje edhe për shkak të përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga rrjetet 4G dhe 4G+ të cilët mundësojnë transmetim me cilësi më të mirë si të mesazheve ashtu edhe të thirrjeve nëpërmjet këtyre aplikacioneve.

Nga tabela e mësipërme, dy janë treguesit që kanë shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2019, konkretisht volumi i trafikut të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare ka shënuar rritje me rreth 29% krahasuar kjo me vitin 2018. Për sa i përket rritjes së thirrjeve hyrëse ndërkombëtare gjatë vitit 2019, rritjen më të madhe e ka shënuar Vodafone Albania me rreth 31 (pp) i cili zë edhe pjesën më

të madhe të këtij trafiku me 83%, ndërsa dy operatorët e tjerë kanë shënuar ulje të trafikut të terminuar të thirrjeve ndërkombëtare krahasuar kjo me vitin 2018.


Nëse e shohim nw njw periudhw mw tw gjatw kohore rezulton se volumi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare ka ardhur në rënie graduale që nga viti 2012 kur ky tregues shënonte rreth 755 milionë minuta, duke shkuar në rreth 168 milionë minuta në vitin 2017.

Gjithashtu, edhe gjatë vitit 2019 ka vijuar trendi rritës i volumit të të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, volum i cili është rritur me rreth 15 pwr qind krahasuar me vitin 2018, dhe nëse krahasohet me vitin 2015 ky tregues është rritur me më shumë se pesë herë. Gjatë vitit 2019, rritjen më të madhe të volumit të të dhënave Data e ka pasur Vodafone Albania me rreth 19 (pp), e ndjekur nga Telekom Albania me rreth 7 (pp), ndërkohë Albtelecom është përfaqësues në të njëjtat nivele si viti 2018.

Numri i përdoruesve celularë

Nga të dhënat e ecurisë së numrit të përdoruesve celularë sipas viteve dhe tremujorëve të vitit 2017-2019 të paraqitura në figurën në vijim, vërehet se treguesit mbi numrin e pajtimtarëve të shërbimeve celulare kanë shënuar rritje nga viti 2014 deri në fund të vitit 2017, për tu ndjekur nga një rënie e theksuar të këtyre treguesve nga tremujori i parë 2018 e në vijim deri në periudhën e fundit të raportimit (T4-2019).

Figura 2: Numri i përdoruesve celularë aktivë dhe karta SIM 2014-2019



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Nga të dhënat e mësipërme, vërehet se treguesit për përdoruesit aktivë të shërbimeve celulare broadband kanë qenë në trend rritës për periudhën 2014 deri në tremujorin e tretë të vitit 2017, për tu ndjekur nga një rënie e lehtë gjatë tremujorit të fundit të këtij viti, periudhë kjo e cila përkon me zhvillimin dhe rritjen e përdorimit të internetit nëpërmjet rrjeteve celulare. Numri i pajtimtarëve mbajtës të kartave SIM ka pasur rritje përgjatë periudhës 2014-2017, kjo edhe si shkak i fushatave promovionale të kompanive celulare dhe mbajtjes së dy apo më shumë kartave SIM nga pajtimtarët. Gjatë fundit të vitit 2017, fillimit të vitit 2018 ky numër ka shënuar rënie të

konsiderueshme ku në periudhën T4-2019 ky numër shënon rreth 3.4 milion pajtimtar (39% më pak se T4-2017).

Gjatë vitit 2018, AKEP u ka kërkuar informacion sqarues sipërmarrësve, mbi bazën e të cilës sipërmarrësit kanë sqaruar se kjo rënie ka ardhur si rezultat i disa faktorëve:

- i. ndryshimit të politikës së zbatuar nga sipërmarrësit në lidhje me jetëgjatësinë e kartave SIM për numrat me parapagesë duke shkurtuar periudhën gjatë të cilës një numër mund të qëndrojë aktiv në rrjet pa kryer rimbushje;
- ii. ndryshimi i politikave të kompanive për sa i përket fushatave promovionale për ofrimin e numrave falas, duke dekurajuar përdoruesit që të përdorin karta SIM për një kohë të shkurtër;
- iii. reduktimi i numrit të kartave nga ana e përdoruesve që mbanin dy ose më shumë SIM, etj.

Ndryshimet e mësipërme kanë bërë që treguesit statistikorë të raportuar të paraqesin më me vërtetësi volumin e numrave që realisht përdorin rrjetin për komunikimet elektronike mobile.

Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G

Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në Internet të paktën një herë gjatë vitit 2019 ishte rreth 2.4 milion, ndërsa numri i përdoruesve aktivë (përdorim të Internetit në tre muajt e fundit) ishte rreth 1.7 milion, që përbën rënie vjetore respektivisht me 7.34% dhe 1.15% (arsyet e operatorëve janë paraqitur në paragrafin e mësipërm). Edhe pse ka pasur rënie të numrit të përdoruesve, volumi i përdorimit të të dhënave (internetit) ka pasur rritje me rreth 15%.

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G

Viti	Telekom Albania	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communications	Total	Norma e penetrimit për popullsi
2011	55,000	228,249	-	-	283,249	10%
2012	240,715	408,998	-	-	649,713	23%
2013	311,566	634,293	285,400	-	1,231,259	43%
2014	225,346	550,196	132,433	-	907,975	32%
2015	375,973	706,880	214,428	-	1,297,281	46%
2016	460,221	921,854	231,321	72,958	1,686,354	60%
2017	613,886	1,030,614	282,077	104,401	2,030,978	72%
2018	605,984	931,730	272,282	-	1,809,996	63%
2019	567,572	940,949	280,737	-	1,789,258	63%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Dy nga operatorët kryesor me rrjete 3G/4G kanë pasur rënie të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparateve celulare. Numri i përdoruesve nëpërmjet kartave USB/modem për vitin 2018 arriti në vlerën 114 mijë përdorues duke shënuar një rënie me 4% në krahasim me vitin 2018.

Penetrimi për popullsi i përdoruesve aktivë celularë të aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G në fund të vitit 2019 arriti në 63% duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin 2018.


Për sa i përket mbulimit të territorit dhe të popullsisë me rrjet LTE (3G/4G) vërehet se ka pasur përmirësim të rëndësishëm në krahasim me vitin 2018. Mbulimi i territorit me rrjet LTE për vitin 2019 rezulton rreth 73%, nga 57% që raportohej për vitin 2018, ndërsa mbulimi i popullsisë me rrjet LTE në vitin 2019 ishte rreth 95% nga rreth 85% që raportohej për vitin paraardhës.

Megjithatë, treguesit e mësipërm nuk janë të njëjtë për të tre operatorët, treguesit më të mirë për mbulimin i ka raportuar Vodafone Albania, e ndjekur nga Telekom Albania dhe në vijim Albtelecom.

Trafiku telefonik dhe SMS

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2019 ishte rreth 5.5 miliard minuta, e cila përbën një rënie me 9% në krahasim me vitin 2018 (6 miliard minuta).

Figura 3: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2013-2019




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Sasia e thirrjeve brenda rrjetit(on-net) vijoi me trendin rënës me 9%, ndërsa thirrjet jashtë rrjetit (off-net) u reduktuan me 8% përgjatë vitit 2019. Gjithashtu, edhe volumi i thirrjeve dalëse drejt rrjeteve ndërkombëtare dhe atyre fikse vendase është në nivele mjaft të ulëta të dy këto tregues përbëjnë më pak se 2% të totalit të thirrjeve dalëse.

Figura e mëposhtme paraqet strukturën e thirrjeve për dy tregues thirrjet on-net vs thirrjet off-net. Nga të dhënat vihen re ndryshime të mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Peshja e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në Janar 2014 në 45% në Nëntor 2017. Në të njëjtën periudhë peshja e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në Janar 2014 në 52% në Nëntor 2017. Pas muajit Nëntor 2017, vërehet një tendencë e kundërt, ku peshja e thirrjeve off-net ka pësuar rënie duke arritur në rreth 41% në Janar të vitit 2019, ndërsa peshja e thirrjeve on-net është rritur në rreth 57%.

Figura 4: Ecuria trafikut mujor on-net/off-net 2014-2019



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare dhe reduktimet në thirrjet on-net në periudhën 2015-2019 kanë ndodhur si rrjedhojë e zbatimit të detyrimit të operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifën e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare që nga muaji korrik 2015.

Vërehet se gjatë viteve 2018-2019 pesha e thirrjeve on-net dhe off-net është stabilizuar në kufijtë përkatësisht rreth 41% off-net dhe rreth 56% on-net.

Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve

Sasia totale e thirrjeve hyrëse (nga rrjetet e tjera) të terminuara në rrjetet celulare në vitin 2019 ishte rreth 2.5 miliard minuta, që përbën rënie me 6% në krahasim me vitin paraardhës. Terminimi i thirrjeve kombëtare u ul me 1% për thirrjet nga rrjetet fikse dhe pësoi një rënie prej 8% për thirrjet nga rrjetet e tjera celulare.

Figura 5: Terminimi i thirrjeve dhe hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare (në minuta) dalëse



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Për sa i përket volumit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare edhe pse në peshë dukshëm më i vogël se ato kombëtare, gjatë vitit 2019 ky tregues shënoi rritje me rreth 30% krahasuar me vitin 2018.

Ndërsa sasia totale e SMS-ve të origjinuara nga përdoruesit celularë në vitin 2019 u reduktua me 20%, terminimi i SMS-ve u reduktua me 6%. Siç mund të vihet re trendi rritës i përdorimit të *Data-ve* është në kah të kundërt me trendin e përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve, duke evidentuar efektin zëvendësues të këtyre shërbimeve tradicionale me shërbimet e ofruara nga aplikacionet OTT që mundësohen nga aksesimi broadband në rrjetet celulare 3G/4G.

Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2012 deri në 2019, sipas treguesit të përdoruesve aktiv. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njëkohësisht tabela përmban dhe përdorimin mesatar mujor për SMS-të dalëse, si dhe për përdorues aktivë broadband.

Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2018
Thirrje dalëse	152	156	172	182	166	155	158	171	8%
Thirrje të marra	168	167	168	171	169	156	161	177	10%
MOU	319	324	341	353	335	311	319	348	9%
SMS Dalese	35	39	43	39	39	33	31	30	-3%
Trafik Data (GB)	N/A	0.2	0.5	1.0	1.5	2.1	2.6	3.4	31%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2019, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 171 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 30 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar rreth 3.4 GB në internet broadband. Faktorët kryesorë që ndikojnë në mesataren e thirrjeve/SMS janë reduktimi i bazës së përdoruesve aktivë të shërbimeve mobile, si edhe rritja e përdorimit të shërbimeve të komunikimit (sms, voice, video) nëpërmjet aplikacioneve OTT.

Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM.

Pjesët e tregut

Deri në vitin 2017 në tregun e ofrimit të shërbimeve elektronike celulare kanë operuar katër operatorë dhe që nga 1 Janari 2018 me daljen e Plus Communications nga tregu ushtrojnë aktivitetin tre operatorë. Edhe pas daljes së Plus nga tregu, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të qenësishëm strukturor për sa i përket pjesëve të tregut, ku operatorët kanë ruajtura pothuajse të njëjtën peshë në treg. Tabela në vijim paraqet pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë të shërbimeve celulare.

Tabela 3: Pjesët e tregut për treguesit kryesor të shërbimeve celulare

	Viti	Telekom Albania	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus
Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card)	2013	39%	43%	13%	6%
	2014	40%	40%	14%	7%
	2015	34%	42%	16%	8%
	2016	32%	49%	14%	4%
	2017	32%	49%	14%	5%
	2018	34%	50%	15%	0%
	2019	33%	50%	17%	0%
Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	2013	38%	45%	12%	6%
	2014	34%	46%	13%	8%
	2015	33%	47%	14%	6%
	2016	31%	51%	13%	5%
	2017	34%	48%	13%	6%
	2018	37%	47%	16%	0%
	2019	36%	48%	16%	0%
Përdorues aktivë broadband (3G/4G)	2013	25%	52%	23%	NIA
	2014	25%	61%	15%	NIA
	2015	29%	55%	17%	NIA
	2016	27%	55%	14%	4%
	2017	30%	51%	14%	5%
	2018	37%	47%	16%	0%
	2019	32%	53%	16%	0%
Thirrje dalëse	2013	39%	51%	7%	3%
	2014	34%	50%	11%	5%
	2015	32%	49%	13%	6%
	2016	34%	52%	11%	4%
	2017	34%	48%	11%	7%
	2018	35%	52%	13%	0%
	2019	34%	53%	13%	0%
SMS dalëse	2013	21%	73%	5%	1%
	2014	19%	66%	5%	10%
	2015	18%	66%	8%	8%
	2016	21%	67%	9%	3%
	2017	25%	60%	10%	5%
	2018	27%	61%	12%	0%
	2019	26%	60%	14%	0%
Trafiku të dhëna (Gbyte)	2013	21%	57%	17%	4%
	2014	16%	49%	30%	4%
	2015	18%	51%	29%	3%
	2016	21%	55%	22%	2%
	2017	24%	55%	18%	2%
	2018	26%	55%	19%	0%
	2019	24%	59%	16%	0%
Të ardhura totale nga komunikimet	2013	33%	50%	11%	6%
	2014	34%	48%	12%	6%
	2015	34%	47%	12%	7%

	2016	31%	49%	12%	9%
	2017	30%	49%	12%	8%
	2018	32%	54%	14%	0%
	2019	31%	54%	14%	0%
Të ardhura retail	2013	32%	52%	11%	6%
	2014	30%	53%	11%	5%
	2015	28%	54%	12%	5%
	2016	28%	56%	12%	5%
	2017	31%	51%	13%	5%
	2018	32%	55%	14%	0%
	2019	31%	55%	14%	0%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile duke shënuar rritje për pjesën më të madhe të treguesve krahasuar me vitin 2018, konkretisht pjesët e tregut për vitin 2019 variojnë me:

- mbi 50 % të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card;
- mbi 47 % të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card activ;
- mbi 59 % të pjesëve të tregut për volumin e SMS dhe trafikut të internetit;
- mbi 52% të tregut për trafikun e minutave dhe përdoruesve aktiv të internetit;
- 54% të tregut për të ardhurat totale,
- 55% për shërbimet me pakicë.

Në vend të dytë është sipërmarrësi Telekom Albania sh.a, që ka shënuar rënie të lehtë të pjesës dërmuese të treguesve kryesorë me rreth 1-2 (pikë përqindje), pjesët e tregut për vitin 2019 variojnë si vijon:

- 26-34% pjesë të tregut për të gjithë treguesit e përdoruesve aktivë, pajtimtarë të kartave SIM, thirrje dalëse, SMS, trafik interneti, përdorues aktivë të broadband;
- 31% të tregut për të dy treguesit të ardhurat totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.

Sipërmarrësi me pjesën më të vogël të tregut është Altelecom i cili ka shënuar rritje të lehtë (rreth 1 pp) të treguesve kryesorë krahasuar me vitin 2018, rënie ka shënuar për treguesin e trafikut të të dhënave nëpërmjet internetit. Pjesët e tregut për vitin 2019 variojnë:

- 12-17% % pjesë të tregut për të gjithë treguesit e përdoruesve aktivë, pajtimtarë të kartave SIM, thirrje dalëse, SMS, trafik interneti, përdorues aktivë të broadband;
- 14% të tregut për të dy treguesit të ardhurat totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.


Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse

Telefonia fikse

Shërbimet e rrjeteve fikse telefoni dhe/ose internet në Shqipëri ofrohen nga rreth 230 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet infrastrukturore të tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkt me përdoruesit fundorë.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2018 ishte rreth 248 mijë, ndërsa në 2019 arriti në rreth 243 mijë, kjo përbën një rënie të lehtë me 2%. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2019 arriti në 8.5% (për 2018 ishte 8.6%), që është shumë më e ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy herë më e ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje me e ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2019



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 51% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe. Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Altelecom në vitin 2019 u reduktua me 19% në krahasim me vitin 2018, ndërsa gjatë vitit 2019 një përdorues i rrjetit fiks të Altelecom gjeneroi mesatarisht 35 minuta thirrje në muaj, krahasuar me 44 minuta në muaj për vitin 2018.

Tabela 4: Pjesët e tregut sipas numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2012 - 2019


	Albtelecom	Abcom	ASC	Abissnet ¹	Nisatel	OA te tjere	Total
2012	230,397	33,000	7,649	N/A	5,500	35,115	311,661
2013	210,382	13,680	15,047	N/A	7,166	34,925	281,200
2014	182,591	15,531	14,010	N/A	9,423	24,202	245,757
2015	180,735	12,316	30,670	N/A	4,828	24,190	252,739
2016	176,733	13,946	37,765	3,823	4,306	15,890	248,640
2017	171,516	15,282	42,829	3,982	2,470	14,623	246,720
2018	177,129	11,637	40,377	4,049	4,100	11,339	248,631
2019	176,653	11,409	35,558	4,095	4,098	11,046	242,859
Ndryshimi 2019/2018	0%	-2%	-12%	1%	0%	-3%	-2%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Sic vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër, operatori me pjesën më të madhe në treg është Albtelecom rreth 72.7%, i ndjekur nga ASC me rreth 14.6%, ABCom me rreth 4.7% dhe Nisatel dhe Abissnet me nga 1.7%. Ajo që konstatohet është se pjesa e pajtimtarëve të Albtelecom pothuajse nuk ka ndryshuar nga ajo e vitit 2018, ndërkohë që ASC ka pasur rënie me rreth 12%.

Në figurën në vijim paraqitet norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas Qarqeve në nivel urban dhe rural.

Figura 7: Norma e penetrimit të Telefonisë Fikse sipas qarqeve dhe zonave Urbane/Rurale (2019)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Nga figura sa më sipër konstatohet se penetrimi i telefonisë fikse në nivel urban dhe rural varion ndjeshëm nga njëri Qark në tjetrin. Qarku me nivelin më të lartë të penetrimit urban është Tirana, i ndjekur nga Gjirokastra dhe Korça, ndërsa për sa i përket penetrimit të popullsisë me linja të

¹ Për Abissnet te dhënat janë paraqitur që nga viti 2016

telefonisë fikse rurale qarku me përqindjen më të madhe është Durrësi, i ndjekur nga Gjirokastra dhe më pas Tirana dhe Vlora.

Tabela 5: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve

	Total	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Abissnet	OA të tjerë
	242,859	176,653	11,409	35,558	4,098	4,095	11,046
Berat	9,468	8,924	176	3	0	0	365
Dibër	3,591	3,590	0	0	0	0	1
Durrës	21,831	14,785	769	5,754	334	117	523
Elbasan	9,481	7,878	734	335	0	43	534
Gjirokastrë	8,249	7,130	0	7	0	56	1,112
Fier	11,519	7,219	1,777	1,116	0	101	1,407
Korçë	16,741	14,502	1,098	47	0	0	1,094
Kukës	2,950	2,937	0	10	0	0	3
Lezhë	9,219	5,839	0	3,375	0	0	5
Shkodër	10,125	7,223	1,024	7	0	291	1,871
Tiranë	122,789	85,799	4,834	24,046	0	3,487	8,110
Vlorë	16,896	10,827	997	858	3,764	0	4,214

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Nga të dhënat e tabelës më sipër evidentohet se operatori i vetëm me praninë e rrjetit të telefonisë fikse në të gjitha Qarqet është Albtelecom, operatorët e tjerë kanë kryesisht përqendrim në zona të caktuara, kryesisht numrin më të madh të pajtimtarëve e kanë në Tiranë.

Aksesi broadband nga rrjete fikse

Numri i pajtimtarëve

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm vitet e fundit, shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse kanë pasur rritje të qëndrueshme vjetore gjatë kësaj periudhe kohore.

Bazuar në raportimet e operatorëve që ofrojnë shërbimet internet nëpërmjet rrjeteve numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2019 arriti në rreth 436 mijë², që përbën një rritje me rreth 20% në krahasim me vitin 2018.

² Përditësuar me të dhënat e dërguara deri me datë 30 Prill 2020

Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete Fikse 2012-2019

	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	Nisatel	Digicom	OA të tjerë	Total
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	N/A	N/A	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	N/A	N/A	29,890	182,556
2014	82,747	47,480	23,259	28,489	N/A	N/A	25,956	207,931
2015	97,597	51,093	24,497	31,357	N/A	N/A	38,326	242,870
2016	109,851	52,442	29,497	37,650	7,421	N/A	36,939	266,379
2017	120,204	55,860	28,633	46,118	7,500	6,378	38,919	303,612
2018	129,329	64,020	37,055	49,359	13,473	14,322	54,389	361,947
2019	133,515	74,708	40,849	52,773	13,809	18,516	101,731	435,901
Ndryshimi 2019/2018	3%	17%	10%	7%	2%	29%	87%	20%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Tabela sa më sipër paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve me akses broadband në periudhën 2012-2019 për operatorët kryesorë në treg. Të gjithë operatorët kryesorë vihet re se kanë ecuri pozitive në vitet e fundit, rritjen më të madhe e kanë shënuar “OA të tjerë” numri i pajtimtarëve të të cilëve gjatë vitit 2019 është rritur me 84% në krahasim me vitin 2018. Albtelecom zotëron 31% pjesë tregu, i ndjekur nga Abcom me 17% pjesë tregu në vitin 2019, Abissnet me rreth 9%, ASC me rreth 12%, ndërsa kategoria OA të tjerë përbën rreth 23% të këtij tregu. AKEP ka filluar të publikojë periodikisht të dhëna dhe tregues statistikore të tregut të komunikimeve elektronike prej muajit Prill 2009 në faqen zyrtare. Gjatë vitit 2019, për shkak të rritjes së sensibilizimit në funksion të formalizmit të këtij tregu, vihet re një rritje prej 45% në numrin e raportimeve nga ana e sipërmarrësve, rritje e cila ka ndikuar në përmirësimin e treguesve të tregut si në termat sasiorë ashtu edhe në ato cilësorë.

Sipërmarrësi me pjesën më të madhe të tregut Albtelecom gjatë vitit 2019 edhe pse ka shënuar rritje të numrit të pajtimtarëve gjatë vitit 2019, ai ka pasur rënie të pjesës së tregut me rreth 5 pp në krahasim me vitin 2018.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi gjatë periudhës 2011-2019.

Figura 8: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve³


³ Të dhënat e popullsisë dhe familjeve sipas Census 2011



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Në vitin 2019 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte 60% për familje (duke shënuar rritje me 10 (pp) krahasuar me vitin 2018) dhe rreth 15.6% për popullsi. Megjithëse numri i pajtimtarëve me akses broadband është në rritje të qëndrueshme, normat e penetrimit janë shumë më të ulëta se në vendet e BE dhe të rajonit.

Figura 9: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2019)




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Të dhënat e mësipërme tregojnë për një normë relativisht të ulët të penetrimit të internetit nëpërmjet rrjeteve fikse në zonat urbane mesatarisht 25% dhe në zonat rurale mesatarisht 5%.

Paketat e integruara (Bundles)

Të dhënat e mësipërme tregojnë se shërbimi telefonik për disa vjet tashmë rezultojn të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, ndërsa nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa (bundles) të shërbimeve të aksesit në Internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezultojn të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/TV) në fund të vitit 2019 arriti në rreth 267 mijë, rreth 19% më shumë se në vitin 2018. Në vitin 2019 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 62% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 41% e pajtimtarëve me paketa të integruara janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

Figura 10: Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2019, numri total i përdoruesve që përdorin shërbime të integruara arriti në rreth 267 mijë, duke shënuar rritje me rreth 19%. Numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta *triple play* (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 2% krahasuar me vitin 2018. Altelecom pati një rritje me 10% krahasuar me një vit më parë në shportën Telefoni fikse dhe Internet, ndërkohë që 63% e përdoruesve me akses broadband të Altelecom ishin me paketa trefishe.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën më sipër, vërehet përdorimi i shërbimeve të integruara (Telefoni, Internet dhe TV) është më i përdoruri ndër tre klasifikimet, i shoqëruar me një rënie të gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018 (rreth 6 pp), sikundër rritje ka pasur përdorimi i shërbimeve të integruara (Internet dhe TV) i cili ka pasur rritje të ndjeshme gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018, rritje e cila ka ardhur si rrjedhojë e ndryshimit të interpretimit të klientit për këtë zë nga Abcom. Ndërkohë që pjesa e tregut për shërbimet e integruara (Telefoni fikse dhe internet) është rreth 32% duke shënuar ulje me rreth 9 (pp) krahasuar me vitin 2018 e cila përbënte rreth 41%.

Tabela 7: Numri i pajtimtarëve të Altelecom me shërbime të integruara (2013-2019)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2018
Numri total i pajtimtarëve me akses broadband	73,242	82,747	97,597	109,851	120,204	129,329	133,515	3%
Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni)	70,961	76,230	93,873	109,034	118,050	126,695	130,665	3%
Telefoni fikse dhe Internet	70,961	60,939	32,293	33,673	37,783	42,503	46,609	10%
Telefoni fikse, Internet dhe IPTV		15,291	61,580	75,361	80,264	84,191	84,056	0%


Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Tabela e mësipërme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara në periudhën 2013-2019. Ndërsa në vitin 2013 shumica e pajtimtarëve të Albtelecom ishin me paketa dyfishe (Telefoni dhe Internet) dhe nuk kishte paketa trefishe, në fund të vitit 2019 rreth 63% e pajtimtarëve me akses broadband të Albtelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).

Teknologjia

Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është DSL e ndjekur nga FTTH/FTTB. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuar fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Figura e mëposhtme paraqet shpërndarjen e lidhjeve broadband fiks sipas teknologjisë në Shqipëri. DSL - FTTN/FTTC është teknologjia kryesore në Shqipëri, ku pjesa e tregut gjatë vitit 2019 ka pësuar një rënie duke shkuar në rreth 39%, krahasuar me rreth 46% të tregut në vitin 2018. Në Shqipëri lidhjet DSL përbëjnë 47% të totalit të lidhjeve broadband fiks dhe shumica e tyre është me kombinim fibër optike + linjë bakri apo FTTN/FTTC.

Figura 11: Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë Shqipëri 2019



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Lidhjet me fibër optike në Shqipëri (FTTH/B) për vitin 2019 përbëjnë 31% të totalit të lidhjeve, me një rritje prej rreth 8pp krahasuar me vitin 2018. Lidhjet kablore në Shqipëri përbëjnë 18%,


ku nga kabllor (DOC SIS 3.0 dhe më shumë) përbën 85% të totalit të lidhjeve kabllore. Pajtimtarët me lidhje në NGA (FTTx + NGA kabllorë) në Shqipëri përbëjnë 15% të të gjitha lidhjeve broadband, ku shumica e tyre janë në ADSL në FTTN/C, ndërsa në vendet e BE ky proporcion është 35% ku shumica janë VDSL, FTTH/B dhe Cable DOC SIS 3.0.

Shpejtësia e aksesit broadband

Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e pajtimtarëve me akses broadband në internet në rrjetet fikse sipas shpejtësive të përdorura në 2015-2019. Siç mund të vihet re shpejtësia më e përdorur është 4-10 Mbps me 53% në 2019. Të dhënat tregojnë se proporcioni i pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi më të ulët se 4 Mbps ka ardhur në rënie ndërsa për shpejtësi mbi 4Mbps ka ardhur në rritje. Në 2019 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi 1 Gbps ose më e madhe nga 141 në 2018 në rreth 553 në 2019.

Në figurën në vijim paraqitet struktura se si është e ndarë struktura e pajtimtarëve me akses broadband sipas shpejtësisë përgjatë periudhës 2015-2019.

Figura 12: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se rreth 99% e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse kanë akses me shpejtësi 2Mbps ose më të lartë. Pjesa e pajtimtarëve me shpejtësi më të ulët se 2 Mbps mbetet 1% në 2019 njësoj si në 2018.

Gjithashtu, konstatohet se gjatë viteve 2018-2019 është rritur ndjeshëm numri i pajtimtarëve që kanë akses broadband nga rrjetet fikse me shpejtësi 10-30 Mbps, gjë e cila përkthehet në cilësi më të artë shërbimi për konsumatorët fundorë. Gjithashtu, konstatohet trendi rritës drejt përdorimit të rrjetit me shpejtësi të lartë, ku pjesët me rritjen më të shpejtë janë pajtimtarët që përdorin shpejtësi nga 100 Mbps në 1 Gbps dhe pajtimtarët që përdorin 1 Gbps ose më shumë. Vlen të theksohet se volumi trafikut të internetit rritur ndjeshëm gjatë vitit 2019 duke arritur në rreth 450 milionë Gbyte, nga rreth 200 milionë Gbyte që rezultonte në vitin 2018.

Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse

Në infrastrukturën aktive shërbimeve të internetit nga rrjetet fikse me pakicë numri i bizneseve 4,598 ndërkohë që numri i linjave të dhëna me qira është 3,810 me kapacitet total rreth 147 mijë mbit/s. Ndërkohë numri i i operatorëve që ofrojnë akses me shumicë është 64 me 2,295 linja që arrijnë kapacitetin 208 mijë mbit/s.

Tabela 8: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2014-2019

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2018
Ofrim akses në infrastrukturë aktive							
Numri i linjave/lidhjeve të dhëna	345	508	532	651	1,466	2,295	57%
<i>Kombëtare</i>	328	489	508	633	1,445	2,265	57%
<i>Ndërkombëtare</i>	17	19	24	18	21	30	43%
Kapaciteti total i dhënë me qira (Mbps)	34,793	36,826	44,423	111,311	176,496	208,661	18%
<i>Kombëtare</i>	33,392	35,346	36,464	107,383	174,616	206,148	18%
<i>Ndërkombëtare</i>	1,401	1,480	7,959	3,928	1,880	2,513	34%
Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)							
<i>Dark fiber</i>	927	924	1,529	1,397	1,809	1,891	5%
<i>Akses në tubacione</i>	19	61	74	72	75	78	4%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Për sa i përket infrastrukturës pasive kontribuuesi kryesor ka qenë Altelecom, i cili ka rritur aksesin në vitin 2019 me 1244 km dark fibër dhe 73 km tubacione, sipërmarrësit e tjerë që kanë rritur aksesin në dhënie me qira të fibrës optike të pandriçuar (dark fibër) janë ATU me 202 km, Abcom me 130 km, ASC me 129 km dhe Abissnet me 89 km.

Altelecom është ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse. Në vitin 2019, 66% e fibrës optike dhe 95% e aksesit në tubacione janë ofruar nga Altelecom.


Treguesit kryesorë të të ardhurave dhe investimeve**Të ardhurat dhe investimet**

Bazuar në raportimet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e komunikimeve elektronike, të ardhurat totale nga ofrimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike për vitin 2019 janë rreth 35.3⁴ miliard lekë, me një rritje rreth 1% krahasuar me vitin 2018. Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë ato të gjeneruara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet të telefonisë celulare, konkretisht rreth 26.3 miliardë lekë, që përbën një rënie me rreth 2% nga viti 2018. Për sa i përket

⁴ Perditesuar me të dhënat e dërguara deri me datë 30.04.2020

të ardhurave nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga rrjetet fikse, të ardhurat e raportuara janë rreth 9 miliardë lekë, shifër kjo rreth 11% më e lartë se ajo e vitit të kaluar.


Figura 13: Të ardhurat⁵ nga Komunikimet Elektronike



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Në figurën në vijim paraqiten të ardhurat nga shërbimet e komunikimeve elektronike për vitin 2019 sipas operatorëve kryesorë.

Figura 14: Të ardhurat nga komunikimet elektronike për vitin 2019 sipas operatorëve kryesorë (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Nga të dhënat e paraqitura në grafikun sa më sipër, evidentohet se operatori me peshën më të madhe të të ardhurave në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike është Vodafone

⁵ Të ardhurat janë paraprake, të dhënat përfundimtare paraqiten pas dorëzimit dhe auditimit të Pasqyrave Financiare

Albania me rreth 41% të totalit të të ardhurave, ndjekur nga Telekom Albania me rreth 23%, sipërmarrësi Albtelecom ndodhet në vendin e tretë me rreth 22% të tregut për të dy rrjetet fikse dhe mobile, Abcom është operatori i dytë i rrjeteve fikse për të ardhurat me rreth 4%, i ndjekur nga ASC me rreth 2%, pjesa tjetër rreth 14% u takon operatorëve të tjerë të rrjeteve fikse.

Gjatë vitit 2019 të ardhurat e gjeneruara nga ofruesit e shërbimeve mobile rreth 26.3 miliardë lekë, paraqiten në nivel të përafërt me atë të vitit 2018 me një rënie prej rreth 2%, rënien më të madhe e ka shënuar Telekom Albania prej rreth 5%, Vodafone Albania me 1%, ndërsa Albtelecom është në të njëjtin nivel si viti kaluar.

Figura 15: Të ardhurat me shumicë dhe pakicë nga rrjetet celulare



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Siç vërehet në grafikun sa më sipër të ardhurat nga shërbimet e ofruara me shumicë (7,809 milionë lekë) kanë pësuar rënie të theksuar gjatë tre viteve të fundit, duke arritur nivelin më të ulët që nga viti 2011, e kundërta ka ndodhur me të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet me pakicë (18,474 milionë lekë) të cilat gjatë periudhës 2017-2019 kanë pësuar rritje të lehtë.

Për sa i përket treguesve të rezultatit financiar, në ndryshim nga viti i kaluar ku Telekom Albania shënonte humbje me rreth 3.6 miliardë lekë, këtë vit kjo kompani ka rezultuar me rezultat neto pozitiv (fitim) rreth 285 milionë lekë. Rezultat pozitiv ka raportuar edhe Vodafone Albania me rreth 1.4 miliardë lekë, shifër kjo sa dyfishi i fitimit të realizuar vitin e kaluar. Në ndryshim nga dy sipërmarrësit e tjerë Albtelecom gjatë vitit 2019 ka raportuar rezultat financiar negativ me rreth 645 milionë lekë, duke e thelluar humbjen nga rreth 330 milionë lekë humbje që raportonte për vitin 2018.

Për sa i përket të ardhurave të Albtelecom nga shërbimet e rrjeteve fikse ka shënuar rënie me rreth 5% gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018, ndërkohë ABCOM dhe ASC kanë raportuar rritje të të ardhurave respektivisht rreth 2% dhe 3%.

Gjatë vitit 2019 investimet totale⁶ të raportuara në infrastrukturën e rrjetit celular arritën vlerën 7.68 miliardë lekë që tregon një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme.

Të tre operatorët mobile kanë raportuar vlera më të larta investimesh se viti i kaluar, konkretisht:

- Vodafone Albania ka investuar në total rreth 3.5 miliardë lekë,
- ndjekur nga Telekom Albania me rreth 2.6 miliardë lekë
- Albtelecom ka investuar në total rreth 1.5 miliardë lekë.

Në shifrat e deklaruara me sipër janë përfshirë edhe pagesat e kryera nga të tre operatorët për pajisjen/rinovimin me autorizime individuale për perdorin të frekuencave.

Për sa i përket investimeve sipas treguesit të formularëve për të dhënat statistikore (në të cilin nuk paraqiten investimet për pagesat për licensa/autorizime të përgjithshme apo individuale dhe pagesat për përdorim të frekuencave), kjo shifër rezulton rreth 4.16 miliardë lekë, që përbën një rritje me rreth 2% më shumë se viti i kaluar.

Ndërkohë pagesat për marrjen/rinovimin për licensa/autorizime të përgjithshme apo individuale, gjatë vitit 2019, sipas operatorëve janë raportuar:

- Albtelecom rreth 1.34 miliardë lekë,
- Telekom Albania rreth 925 milionë lekë
- Vodafone Albania rreth 1.26 miliardë lekë.

Investimet në rrjetet fikse gjatë vitit 2019 raportohen rreth 1 miliardë e 225 milionë lekë çka përbën një ulje të ndjeshme me investimet e raportuara një vit më parë rreth 2 miliardë e 498 milionë lekë, megjithatë kjo shifër pritet të jetë më e lartë pas raportimit të pasqyrave financiare dhe auditimit të tyre.

⁶ Në raportin vjetor të veprimtarisë së AKEP për vitin 2019, është deklaruar totali i investimeve ku për dy operatorët Vodafone Albania dhe Telekom Albania janë përfshirë në zerin e investimeve edhe pagesat për marrjen e autorizimeve individuale respektivisht rreth 7.44 milionë euro për të drejtat e përdorimit të frekuencave në brezin 800 MHz. Në këtë dokument të treguesve statistikore, është saktësuar vlera totale e investimeve duke pasqyruar edhe rinovimin e licensës së Albtelekom në brezin e frekuencave 900/1800 MHz. Në këtë mënyrë reflektohen në mënyrë të saktë investimet për të tre operatorët celularë duke përdorur të njëjtin standart për përfshirjen në zerin e investimeve blerjen/rinovimin e frekuencave/licensave. Në këtë mënyrë rishikimi i zërit të investimeve bëhet pas rikonfirmimit të investimeve të raportuara nga operatorët sipas kërkesave të formularit të deklarimit të të dhënave vjetore, si edhe investimet në total të kryera nga operatorët për rrjetet mobile.